



AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/N5-24 Prot.

Tiranë 11/12/2025

Nr. Dok. 202500963/24

Lënda: *Rekomandim për të garantuar respektimin e plotë të së të drejtës
për përfitimin nga rindërtimi i banesës së dëmtuar prej fatkeqësisë
natyrore të shtetasit E.K.. (P. K.)*

Drejtuar: **BASHKISË SHIJAK**
Z. Kryetar

Shijak

Për dijeni: **INSTITUTIT TË NDËRTIMIT**

Tiranë

NJËSISË ADMINISTRATIVE XHAFZOTAJ

Shijak

Z. E. K.
Adresa: Lagjia 4, Rruga "Mynyku"

Kamëz

Të nderuar,

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, sikurse jeni në dijeni shtetasi E. K., ka parashtruar një ankesë ndaj Bashkisë Shijak dhe Njesisë Administrative Xhafzotaj, në të cilën ka

parashtruar ndër të tjera se, tërmeti i vitit 2019, e ka bërë të pabanueshme banesën e tij, e cila ndodhet në adresën: fshati “Vëllazërim”, Rruga: “Koldashi”, Njësia Administrative Xhafzotaj.

Më tej ka sqaruar se, nga ana e Bashkisë Shijak, klasifikimi i dëmtimeve të banesës së tij është caktuar i nivelit “DS2” duke e konsideruar atë të riparueshme dhe për rikonstrukcionin e saj i ka akorduar vlerën prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Mirëpo ankuesi nuk e ka tërhequr këtë shumë pasi pretendon se është e pamjaftueshme për rregullimin e shtëpisë, sepse ajo është shumë e dëmtuar aq sa është e pabanueshme.

Sikundër shkruan ankuesi, lidhur me këtë problematikë ai është ankuar pranë institucionit që ju drejtoni, në mënyrë të përsëritur duke kërkuar rivlerësimin e rastit¹, me dëmtime të nivelit “DS4”. Kjo kërkesë sipas tij i referohet qëndrimit fillestar të mbajtur në aktin e konstatimit nga tre ekspertë të ndërtimit që kanë vajtur në vend për të verifikuar dëmtimet në banesë. Ata i kanë shpjeguar nënës së tij shtetas P. K., e cila aktualisht banonte aty se, shtëpia do të riparohet nga themelet pasi ka dëmtime në nivelin “DS4”. Për pasojë i kanë kërkuar asaj që të largohet nga banesa. Në vijim për 6 muaj ajo është trajtuar me bonus qiraje. Por më pas ky bonus qiraje i është ndërprerë.

Ankuesi shprehet gjithashtu se, ka një mospërputhje të situatës faktike të banesës si dhe kategorizimit të shkallës së dëmtimeve si “DS2”, ç’ka rezulton qartë edhe nga fotot e dërguara të banesës së tij. Prandaj nisur nga kërkesat e ankuesit, Bashkia Shijak me shkresën nr.1381 prot. datë 20.05.2021, i është drejtuar me kërkesë për rivlerësim të objektit të z. E. K. Institutit të Ndërtimit, për të cilën nuk ka një qëndrim përfundimtar.

Aktualisht shtëpia është në kushtet që po rrënohet çdo ditë e më shumë pasi nuk po kryhet asnjë lloj punimi atje për rindërtimin e saj. Mirëpo deri më sot nuk ka gjetur ende zgjidhje.

Pas rregjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore të formës dhe të përmbajtjes për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, respektivisht nenet 13, 17 shkronja “a” dhe 18 shkronja “b”, ka vendosur ta pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

-I-

Qëndrimi i Bashkisë Shijak, Institutit të Ndërtimit dhe Njesisë Administrative Xhafzotaj lidhur me rastin.

Për shqyrtimin me objektivitet të kësaj çështje dhe për të mundësuar një hetim të plotë administrativ, në vështrim të nenit 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të*

¹ Ankesa e fundit nr 1486 prot., datë 08.04.2024

Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij”, si dhe në nenin 19, gërma “b” të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar, në të cilin parashikohet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”, me shkresat nr. K3/N5-6 prot., datë 09.07.2024, “kërkesë për shpjegime” dhe nr. K3/N5-8 prot., datë 28.08.2024, nr. K3/N5-9 prot., datë 25.10.2024 “Kërkesë e përsëritur për shpjegime”, i kemi kërkuar Bashkisë Shijak dhe Njesisë Administrative Xhafzotaj, dhënien e shpjegimeve të nevojshme si dhe dokumentacionin përkatës ligjor që ka të bëjë me rastin në fjalë, e konkretisht:

- *A i keni kthyer përgjigje shtetasit E. K., lidhur me kërkesën nr. 1486 prot., datë 08.04.2024, të depozituar pranë institucionit tuaj?*
- *A keni marrë përgjigje nga Instituti i Ndërtimit për shkresën tuaj nr.1381 prot., datë 20.05.2021? Nëse po, na dërgoni një kopje të saj.*
- *Bazuar këtij qëndrimi, çfarë masash konkrete keni ndërmarrë apo do të ndërmerni për zgjidhjen e kësaj situate për rindërtimin e banesës së ankuesit të dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019?*
- *Çdo informacion tjetër që ka lidhje me këtë çështje.*

Me shkresat nr. 3638/2 prot., datë 28.10.2024 dhe nr. 4663/1 prot., datë 01.11.2024, Bashkia Shijak, Drejtoria Juridike, në përgjigje të shkresës sonë na ka informuar se, referuar aktit normativ nr. 9, neni 34, pika 4, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, VKM nr. 26, datë 15.01.2020, “Për kryerjen e akt ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”, VKM nr. 05, datë 06.01.2020, kreu IV, pika a, b, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga Programi i Granteve të Rindërtimit dhe Projektet Model”, niveli i dëmit në objekt “DS2”, përkon me masë shpërblim dëmi dhe rikonstrukcion objekti 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Bashkia Shijak për këtë nivel dëmi ka miratuar shpërndarjen e grantit me VKB nr.46, datë 22.05.2020, tek subjektet përfituese, të cilët do të mund të kryenin riparimet e objektit me fondin takues.

Për sa më sipër, Instituti i Ndërtimit ka sjellë në rrugë zyrtare akt ekspertizën e thelluar ku ka klasifikuar dëmet në objektin e shtetas P.K. me nivel DS2. Bëjmë me dije se ky nivel nuk përfshihet në programin e granteve për rindërtim, por grantit për riparimin e banesës”.

Në analizë të përmbajtjes së përgjigjes së mësipërme të dërguar nga Bashkia Shijak, kemi konstatuar se nuk kemi marrë përgjigje për të gjitha pyetjet e parashtruara nga ana jonë të cilat ne i kemi konsideruar të rëndësishme në kuadër të planit të hetimit administrativ, të rastit në fjalë.

Në këtë kontekst, me qëllim jo vetëm të identifikimit sa më të saktë të problematikës konkrete në fjalë, por edhe të zgjidhjes së saj, ju kemi kërkuar me shkresa të përsëritura, të na dërgoni përgjigje në mënyrë shteruese respektivisht për secilën nga pyetjet e parashtruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit, si dhe dokumentacionin përkatës lidhur me rastin. Konkretisht:

- *A i keni kthyer përgjigje shtetasit E. K., lidhur me kërkesën nr. 1486 prot., datë 08.04.2024, të depozituar pranë institucionit tuaj?*

- *A keni marrë përgjigje nga Instituti i ndërtimit për shkresën tuaj nr. 1381 prot., datë 20.05.2021?*
- *Nëse po, na dërgoni në kopje të saj. (pasi nga kopjet e akteve të dërguara nga ana juaj bashkëlidhur shkresës tuaj nr. 3638/2 prot., datë 28.10.2024, kemi konstatuar se, nuk është pjesë përbërëse e korrespondencës që keni patur me Institutin e Ndërtimit, për rastin në fjalë, e për pasojë nuk është dërguar qëndrimi i Institutit të Ndërtimit për rivlerësim të objektit në zbatim të kontratës nr. 3387/1 prot., datë 28.05.2021, të lidhur midis jush dhe Institutit të Ndërtimit.*

Në vijim të korrespondencës me shkresën nr. 4663/1 prot, datë 05.11.2024, Bashkia Shijak, në përgjigje të shkresës së mësipërme, na ka informuar se, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 3638/2 prot., datë 28.10.2024.

Pavarësisht këtij qëndrimi në kushtet kur nga përmbajtja e shkresës ishte evidente se informacioni i kërkuar nga ana jonë nuk është dhënë i plotë por vetëm i pjesshëm, i jemi ridrejtuar Bashkisë Shijak me shkresën nr. K3/N5-14 prot., datë 12.03.2025, ku i kemi rikërkuar të na dërgojë një informacion analitik dhe shterues si dhe dokumentacionin përkatës ligjor që ka të bëjë me çështjen objekt hetimi administrativ e në mënyrë specifike të na informojë nëse, është *bërë rivlerësimi i objektit të z. E. K. nga Instituti i Ndërtimit referuar shkresës nr. 596/2 prot., datë 24.05.2021. Nëse po, cili ka qenë konkluzioni përfundimtar? (na dërgoni një kopje të saj).*

Ju bëjmë me dije se, lidhur me sa sipër, nga ana institucionit që ju drejtoni sërish nuk është kthyer përgjigje edhe pse nuk kemi konstatuar ekzistencën e ndonjë shkakut ligjor i cili do të mund të justifikonte vonesën, apo mosdhënien e saj.

Ndërsa me shkresën nr. 171/1 prot., datë 30.04.2025, Njësia Administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak ka informuar ndër të tjera se, për informacionin e kërkuar duhet t'i drejtoheni Bashkisë Shijak pasi çdo dokumentacion dhe dosja e aplikantëve në lidhje me tërmetin e datës 26.11.2019, është dorëzuar në Arkivën e institucionit të Bashkisë dhe e gjithë korrespondenca dhe kërkesat që parashatrojnë me Institutin e Ndërtimit dhe Institucione që lidhen me të janë kryer dhe menaxhuar me Bashkinë Shijak dhe jo me Njësinë Administrative Xhafzotaj. Pranë kësaj Njësie është kryer verifikimi paraprak dhe aplikimi on line, pjesa tjetër është menaxhuar nga Bashkia Shijak. Edhe kërkesa e ankuesit E. K. është dërguar për ndjekje pranë kësaj Bashkie.

Në kuadër të planit të hetimit me qëllim zgjidhjen e drejtë të rastit, Institucioni i Avokatit të Popullit, i është drejtuar me shkresën nr. K3/N5-15 prot., datë 12.03.2025, “Kërkesë për informacion” dhe nr. K3/N5-17 prot., datë 23.04.2025 “kërkesë e përsëritur për informacion dhe dërgimin e dokumentacionit zyrtar”, Institutit të Ndërtimit, nëpërmjet të cilave i kemi bërë me dije se, shtetasi E. K. ka bërë ankesë pranë Bashkisë Shijak, pasi ka pretenduar se shtëpia e tij është e pabanueshme dhe për pasojë nuk mund të klasifikohet si “DS2”. Më tej në kushtet kur midis këtij institucioni dhe Bashkisë Shijak është lidhur kontrata e datës 28.05.2021, me objekt rivlerësimit të objektit të z. E. K., me adresë: fshati “Vëllazërim”, Rruga: “Koldashi”, Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak për nevojë të shqyrtimit të kësaj çështje nga ana e

Institucionit tonë, i kemi kërkuar të na dërgojë qëndrimin e tij përfundimtar në zbatim të kësaj kontrate, se si është klasifikuar banesa e shtetasit E. K., si dhe kopje të dokumentacionit përkatës ligjor.

Në përgjigje të shkresës tonë nr. K3/N5-15 prot., datë 12.03.2024, Instituti i Ndërtimit, me shkresën nr. 507/1 prot., na ka informuar ndër të tjera se: “Nga verifikimi në databazën e akt-ekspertizave të hartuara nga Instituti i Ndërtimit, rezulton se akt ekspertiza e thelluar e objektit të dëmtuar nga tërmeti e znj. P. K. në fshatin “Vëllazërim”, rruga: “Koldashi”, Njësia Administrative Xhafzotaj është kryer nga ana e ekspertëve tanë më datë 21.02.2020 dhe është dërguar me shkresë përcjellëse pranë Bashkisë Shijak me nr. 645 prot., datë 02.03.2020. Referuar kësaj akt ekspertize nga ekspertët në pikën konkluzionale është lënë që ndërtesa objekt i ekspertimit (*me nivel DS4 në akt konstatimi*) vlerësohet:

- *I pasigurt në përdorim*
- *Me rrezik për dëmtimin e shëndetit dhe humbjen e jetës së njerëzve.*

Akt ekspertiza me shkallë dëmtimi “DS2”, së cilës i referoheni nuk ndodhet në databazën e Institutit të Ndërtimit”.

Në përfundim ka rekomanduar:

- Prishjen e ndërtesës ekzistuese dhe ndërtimin e një të reje, si variantin më të mirë në termat e sigurisë të jetës dhe efektivitetit afatgjatë në përdorim.
- Marrjen e masave administrative nga organet kompetente në bashkëpunim me pronarët e ligjshëm në referencë me aktet ligjore, rregullat teknike, standartet në fuqi dhe praktikën më të mirë të ndërtimit.

Bashkëlidhur është dërguar edhe korrespondenca përkatëse me Bashkinë Shijak (akt ekspertiza e thelluar si dhe shkresa për dërgimin e kësaj akt ekspertize nr. 645 prot., datë 02.03.2020).

Në këto kushte i jemi ridrejtuar Bashkisë Shijak me shkresën nr. K3/N5-21 prot., datë 08.07.2025, nëpërmjet së cilës i kemi kërkuar të na sqarojë se cilat janë veprimet e ndërmarra prej saj pas dërgimit me shkresë përcjellëse nga Instituti i Ndërtimit i akt ekspertizës së thelluar lidhur me banesën e shtetasit P.K. (E.K.) pranë Bashkisë Shijak me nr. 645 prot., datë 02.03.2020. Pse nga ana e saj dëmtimet e banesës janë konsideruar “DS2”, ndërkohë që nga akt ekspertiza e thelluar e ndodhur në databazën e akt-ekspertizave të hartuara nga Instituti i Ndërtimit këto dëmtime janë vlerësuar të nivelit “DS4”?

Me shkresën nr. 3252/1 prot., datë 31.07.2025, Bashkia Shijak, Drejtoria Juridike ka informuar se, nuk kanë korrespondencë tjetër veç shkresave të dërguara. Për objektin e shtetasit të sipërcituar, nuk është bërë rivlerësim prandaj vijon të mos përfshihet në programin e granteve për rindërtim por për rikonstrukcion të banesës referuar mendimit sipas akt ekspertizës të thelluar nga ing. përgjegjës të Institutit të ndërtimit.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit, konkluzione dhe rekomandime

Në nenin 108, pika 3, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar se Bashkitë² janë njësia bazë e qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisëse me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njësive të tjera të qeverisjes vendore.

Bashkia duhet të luajë një rol sa më proaktiv, udhëhequr nga parimi i autonomisë vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ajo është e veshur me përgjegjësi efektive që mundësojnë një drejtim sa efikas, aq edhe afër qytetarit.

Për t'u rikthyer tek rasti objekt vlerësimi, njësia e qeverisjes vendore është një nga autoritetet përgjegjëse për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore referuar nenit 12, të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave *“Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”*, të miratar me ligjin nr. 97/2019. Në këtë akt normativ ka gjetur rregullim ligjor edhe funksionimi i organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse. Ndër parimet e përgjithshme të rindërtimit është ai i një strehimi të përshtatshëm dhe i përmirësimit të kushteve të jetesës me qëllim që rimëkëmbja nga gjendja e fatkeqësisë natyrore, për aq sa është e mundur, të garantojë kthimin në kushte optimale jetese dhe funksionimi të komuniteteve të prekura nga fatkeqësitë natyrore

Në nenin 5, pika 1, të aktit të sipërcituar është parashikuar se: *“Subjekte përfituese janë individët dhe familjet, që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore si dhe institucionet publike që kanë pësuar dëme në ndërtesat apo infrastrukturën publike në pronësi apo në administrim të tyre, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, nënjësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore”*.

Ndërsa në pikën 4, të po kësaj dispozite është parashikuar se: *“Individët dhe familjet, banesa e të cilëve është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, por që nga autoritetet përgjegjëse është vlerësuar si e banueshme, nëse nuk kanë përfituar nga ndonjë program tjetër i procesit të rindërtimit, përfitojnë kompensimin e dëmeve, sipas parashikimeve të këtij akti”*.

Në nenin 18, procesi i rindërtimit dhe programet e tij: *“Procesi i rindërtimit dhe programet e tij është parashikuar se:*

“1. Procesi i rindërtimit është një proces i integruar zhvillimi i përbërë nga disa programe, në funksion të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe të shëndetit pas shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, që përcaktohen në këtë nen.

2. Programi i zhvillimit të objekteve të reja që përbëhet nga këto nënprograme:

² përfshirë këtu edhe atë Shijak

a) Zhvillimi i objekteve të reja dhe i zonave të reja për zhvillim, përfshirë infrastrukturën publike përkatëse, si dhe rikonstruksioni i ndërtesave ekzistuese të dëmtuara dhe të infrastrukturës publike nga autoritetet shtetërore;

b) Zhvillimi i objekteve të reja dhe zonave të reja për zhvillim, përfshirë infrastrukturën publike përkatëse, si dhe rikonstruksioni i ndërtesave ekzistuese të dëmtuara dhe i infrastrukturës publike, nga autoritetet shtetërore nga donatorët;

c) Rindërtimi i ndërtesave të shembura nga fatkeqësia natyrore në të njëjtin truall;

ç) Programi i bashkëpunimit për ndërtim në bashkëpunim me sektorin privat.

4. Programi i krijimit të fondit të banesave përbëhet nga: a) Programi i blerjes së banesave të reja në treg të lirë; b) Programi i banesave të dhuruara nga subjektet private.

5. Programi i granteve të rindërtimit përbëhet nga:

a) Granti për rindërtimin ose rikonstruksionin e banesave të dëmtuara;

b) Pagesa e qirasë për familjet e mbetura të pastreha nga fatkeqësia natyrore;

c) Kompensimi i shpenzimeve të subjekteve të sektorit privat që ofrojnë struktura akomoduese për familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore.

6. Programi i masave të rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike që përbëhet nga këto nënprograme:

a) Kompensimi i dëmeve nga fatkeqësia natyrore;

b) Masat për rimëkëmbjen sociale;

c) Masat për rimëkëmbjen ekonomike;

ç) Masat rikuperuese dhe parandaluese.

7. Kushtet, kriteret, kategoritë prioritare, procedurat dhe rregullat për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, përfshirë dhe autoritetet përgjegjëse shtetërore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Përfituesit nuk mund të përfitojnë në të njëjtën kohë nga më shumë se një program i procesit të rindërtimit për qëllimstrehimi, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë akt. Autoritetet përgjegjëse marrin masa që subjektet të cilat nuk përfitojnë nga një program i caktuar, të kenë mundësi për të kaluar në njëprogram tjetër të procesit të rindërtimit, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara nëvendimin e Këshillit të Ministrave. Subjektet përfituese nga programet e procesit të rindërtimit konsiderohen që shpërblehen, jo më shumë se vlera e dëmit real të përbërë nga humbja e pësuar e jetës së njeriut dhe/ose vlera e dëmeve pasurore”.

Në nenin 25, paragrafi i parë “Grantet për rindërtimin e banesës” është parashikuar se: “Përfitojnë grante ndërtimi ose rikonstruksioni, sipas projekteve model, familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, shtëpitë e banimit individuale të të cilëve janë klasifikuar si objekt i dëmtuar ose i pabanueshëm. Rregulla për projektet model, masa e përfitimit, kushtet, kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e kërkesave dhe shpërndarjen e grantit parashikohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërsa në nenin 26 “pagesa e qirasë” është parashikuar se: “Familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, të mbetura të pastreha pasi banesat ose shtëpitë e banimit individuale të tyre janë klasifikuar si objekt i dëmtuar ose i pabanueshëm, përfitojnë një pagesë qiraje në vlerën mesatare të tregut të lirë, për një vit, që miratohet me vendim të organeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore.

2. Për përfitimin e pagesës së qirasë, subjektet përfituese aplikojnë pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku kanë vendbanimin, duke dorëzuar dokumentacionin, si më poshtë

vijon: a) Formularin e aplikimit sipas formatit të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore; b) Aktkonstatimin e Institutit të Ndërtimit; c) Certifikatën familjare; ç) Numrin e llogarisë në një bankë të nivelit të dytë. 3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë procedurat e përshpejtuara për shqyrtimin e aplikimeve dhe miratimin përkatës të subjekteve përfituese dhe të nivelit të qirasë me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. 4. Pagesa e qirasë, pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, mund të miratohet deri në përfitimin e banesës së re nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose deri në përfundimin e ndërtimit apo të rikonstruksionit të banesës, në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit të parashikuara në këtë ligj, nëse përfituesi plotëson kriteret dhe dokumentacionin përkatës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për strehimin social. 5. Shpenzimet e qirasë përballohen nga fondi i rindërtimit, si dhe nga të ardhurat e njësive tëvetëqeverisjes vendore.

Në nenin 34 “Aktekspertiza e thelluar e ndërtesave të dëmtuara” është parashikuar se:

“1. Për ndërtesat që kanë pësuar dëme dhe që janë shpallur të pabanueshme nga aktkonstatimet apo aktvlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore me qëllim garantimin e jetës dhe shëndetit, mund të kryejnë aktekspertizë të thelluar sipas procedurës të përcaktuar në këtë nen. Aktekspertiza e thelluar kryhet dhe për të gjitha ato objekte kur sipas aktkonstatimeve ose aktvlerësimeve paraprake të Institutit të Ndërtimit, apo grupeve përkatëse të inspektimit, kërkohet një rivlerësim më i thelluar.

2. Aktekspertiza e thelluar përmban, përveç të tjerave, përshkrimin e hollësishëm të gjendjes së objektit, dëmet e pësuar, gjendjen strukturore, masat për riparimet dhe ndërhyrjet që duhen kryer për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, si dhe vlerën financiare për këto ndërhyrje. Ekspertiza jep një konkluzion të qartë mbi gjendjen strukturore, nëse objekti mund të riparohet apo struktura e tij është dëmtuar në atë masë që dikton prishjen e detyruar të objektit.

3. Aktekspertiza e thelluar i nënshtrohet oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit dhe opinioni i tij mbizotëron mbi aktekspertizën e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse.

4. Nëse sipas studimit të thelluar, të mbështetur dhe nga oponenca e Institutit të Ndërtimit, ndërhyrjet për riparimin e strukturës kushtojnë më shumë se 70% e kostos së rindërtimit nga e paratë ndërtesës, njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës vendos shembjen e detyruar të objektit, që kryhet sipas procedurave të parashikuara në nenin 35 të këtij akti...”

Procedura e përfitimit nga programi i rindërtimit është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr.5, datë 06.01.2020, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i cili në pikën 13 të tij parashikon se, “Njësitë e vetëqeverisjes vendore rregjistrojnë aplikimet në një sistem elektronik, i cili jep mundësinë e përpunimit të të dhënave, si më poshtë vijon: a) emrin, atësinë, mbiemrin; b) numrin e aplikimit; c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit; ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për të përfituar nga programi i grantit të rindërtimit dhe tipi i projektit model të zgjedhur ose projektin e kryer vetë nga

kërkuesi/aplikanti; d) adresën e kërkuesit; dh) Përbërjen familjare në momentin e aplikimit; e) aktekspertizën e thelluar, të lëshuar nga Instituti i Ndërtimit ose grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose çdo person, fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa e shpallur si e pabanueshme; ë) çdo lloj dokumentacioni që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar; f) të dhënat e llogarisë bankare të kërkuesit pranë një banke të nivelit të dytë.”.

Në pikën 18, të tij është parashkuar se: “Përfitues të granteve të rindërtimit janë individët ose familjet shtëpitë individuale të të cilëve duhen ndërtuar nga e para sipas parashikimeve në aktekspertizën e thelluar. Masa e grantit llogaritet sipas parashikimeve të kreut III, të këtij vendimi³ .

Në vijim në kreun IV është parashkuar se: “Përfitojnë vlerën e plotë të rikonstruksionit individët ose familjet: a) shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve, kur nuk përbëjnë raste si ato të parashikuara në pikën 18, të kreut II, të këtij vendimi dhe që janë shpallur të pabanueshme pasi janë dëmtuar në mbi 2/3 e tyre dhe/ose si pasojë e dëmtimeve të mëdha strukturore ose dëmtimeve shumë të rënda jostrukturore, janë rrezik për shembje, vërtetuar nga aktekspertiza e thelluar; b) shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve, kur nuk përbëjnë raste si ato të parashikuara në pikën 18, të kreut II, të këtij vendimi, dhe që janë shpallur të pabanueshme pasi janë dëmtuar në mbi 2/3 e tyre dhe/ose si pasojë e fatkeqësisë natyrore kanë dëmtime shumë të rënda strukturore, vërtetuar nga aktekspertiza e thelluar.

Duke ju kthyer rastit konkret, referuar dokumentacionit të çështjes, konstatojmë se, në përcaktimin e nivelit të dëmit “DS2”, nga Bashkia Shijak ka pasur një gabim material, pasi nuk i është referuar në mënyrë të saktë aktekspertizës së thelluar të dërguar nga Instituti i Ndërtimit i cili e ka përcaktuar në mënyrë eksplicite nivelin e dëmit “DS4”, ashtu sikurse përcaktuar edhe në aktin e konstatimit, si një akt i cili vjen nga autoriteti përgjegjës shtetëror. (korrespondencë që do jua përcjellim bashkëlidhur këtij rekomandimi).

Kjo sjell si pasojë mundësinë e rishikimit dhe zgjidhjes së problematikës në këtë rast nga ana juaj. Këtu kemi parasysh edhe përmbajtjen e legjislacionit në fuqi i cili parashikon shprehimisht mënyrën dhe rastet se kur qytetarët përfitojnë nga rastet e fatkeqësive natyrore. Konkretisht në nenin 1 të VKM nr. 26 datë 15.01.2020 “Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”, në të cilin është parashkuar se: “Njësitë e qeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore do të kryejnë aktekspertizë të thelluar për të gjitha objektet për të cilat kërkohet një rivlerësim më i thelluar mbështetur në akt konstatimet apo akt vlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo të grupeve përkatëse të inspektimit”, si dhe nenin 2 të tij në të cilin është parashkuar se: “Akt eksperiza e thelluar i

³ Ndërsa në pikën 19, të këtij vendimi parashikohet se: “Aplikantëve jofitues, struktura përgjegjëse u njofton edhe arsyet e kësaj vendimmarrjeje si dhe të vendimit për përfitim nga një program tjetër i procesit të rindërtimit, nëse kjo është e mundur. Aplikantët jofitues mund të paraqesin ankesat e tyre pranë kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose pranë autoritetit përgjegjës, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.”

vihet në dispozicion Institutit të Ndërtimit për kryerjen e oponencës. Instituti i Ndërtimit jep opinionin e tij i cili mbizotëron mbi aktekspertizën e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e qeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse.

Pra akt ekspertiza e thelluar e Institutit të Ndërtimit është një dokument teknik i specializuar dhe që prevalon mbi çdo lloj vlerësimi tjetër (qoftë edhe ai i Bashkisë). Edhe nga ana e Bashkisë gjatë administrimit të rastit “*de facto*”, që në fillim ka rezultuar se familja e ankuesit është konsideruar e pastrehë për shkak se objekti për shkak të dëmtimeve të pësura është konsideruar i pabanueshëm dhe për pasojë ai ka përfituar pagesën e qirasë nga ana e Bashkisë, konform nenit 26 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratar me ligjin nr. 97/2019.

Në këto rrethana, me qëllim për të rivendosur të drejtën e qytetarit si dhe për të siguruar ndërhyrjen e duhur në objektin e dëmtuar ashtu sikurse përcaktuar në akt ekspertizën e thelluar të Institutit të Ndërtimit datë 21.02.2020⁴, e cila është e vetmja aktekspertizë e cila ndodhet në databazën e këtij instituti vlerësojmë sa më poshtë vijon:

Kodi i Procedurës Administrative (KPrA) në nenin 112 të tij “*Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ*”, ka parashikuar se: “*1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ. 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*”

Aktet me gabime materiale nuk janë të paligjshme (neni 112 KPrA) dhe për këtë arsye ato nuk çojnë në ngritjen e padive gjyqësore.⁵ Vetë ankuesi e ka kundërshtuar vendimmarrjen për vlerësimin e objektit “DS2” dhe ka kërkuar rishikim të rastit të tij bazuar në akt ekspertizën e thelluar të Institutit të Ndërtimit.

Duke u ndodhur para kësaj situate, çmojmë se për shkak të gabimeve të drejtshkrimit dhe të përlllogaritjes dhe gabimeve të tjera të dukshme, dispozita përjashtimore e nenit 112, i lejon organit publik të korrigjojë gabimet e tilla duke “*qartësuar*” me mjete më pak formale administrative atë që njihet nga versionin i pakorrigjuar i aktit. Në këtë mënyrë, dispozita ndjek qëllimin e garantimit si të parimit të qartësisë ligjore ashtu edhe të efikasitetit të procedurës administrative (neni 18) ⁶ Korrigjimi mund të kryhet kryesisht ose me kërkesë të palëve.⁷

⁴ Pasi nuk ka patur ekspertizë tjetër për rivlerësim të objektit sikurse citohet nga Instituti i Ndërtimit . *Akt ekspertiza me shkallë dëmtimi “DS2”, së cilës i referoheni nuk ndodhet në databazën e Institutit të Ndërtimit*.

⁵ Komentari i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë fq. 516, nga SIGMA, Tiranë, 2018.

⁶ Komentari i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë fq. 516, nga SIGMA, Tiranë, 2018.

⁷ Komentari i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë fq. 516, nga SIGMA, Tiranë, 2018.

Në gjykimin tonë, mungesa e veprimit për korrigjimin e gabimit material, i cili është një fakt tashmë i provuar nga akteksperiza e thelluar datë 21.02.2020, ku rezulton se ndërtesa objekt ekspertimi është klasifikuar me nivel dëmtimi “DS4”, përbën një shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe efektivitetit të administratës. Rrjedhimisht, mosveprimi i Bashkisë Shijak për të trajtuar në mënyrë substanciale këtë kërkesë të qytetarit, pavarësisht kalimit të afatit formal të ankimit, përbën jo vetëm mosrespektim të nenit 112 të KPrA-së, por edhe një mungesë vullneti administrativ për të ndrequr një padrejtësi të dokumentuar dhe të shmangshme.

Në këtë kontekst, bëjmë me dije se, dispozita e mësipërme nuk përmban asnjë kufizim kohor për korrigjimin e gabimeve materiale, pikërisht për të shmangur situata ku qytetarët dëmtohen për shkak të pasaktësive të vetë administratës. Kjo nënkupton se, detyrimi për të vepruar në këtë rast nuk është fakultativ, por një detyrim pozitiv i organit publik për të përmirësuar një akt të gabuar që prodhon pasoja të padrejta.

Sa u parashtrua më sipër, është qëndrim i qartë i Institucionit të Avokatit të Popullit se, kur ekziston një provë dokumentare, sikurse është rasti i aktekspertizës së thelluar bazuar në nenin 34, pika 3, e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave, ku parashikohet se: “Aktekspertiza e thelluar i nënshtrohet opionencës teknike nga Instituti i Ndërtimit dhe opinion i tij mbizotëron mbi aktekspertizën e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse”, vlerësojmë se administrata nuk ka asnjë justifikim ligjor për të refuzuar rishikimin e çështjes në rrugë administrative. Përkundrazi, çdo neglizhencë në këtë drejtim është shkelje e detyrimeve themelore ligjore dhe kushtetuese të administratës ndaj qytetarëve.

Duhet theksuar se, Avokati i Popullit është institucion kushtetues, i cili ka rol *“kontrollues”* mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike në lidhje me, zbatimin e respektimin e të drejtave kushtetuese, duke ndihmuar individët që t’u krijohen shanse të barabarta, të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën publike, përveç gjykatave.

Legjislatori ka parashikuar si veçori themelore të institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga institucionet e tjera dhe nga çdo ndikim politik, lehtësinë e kontaktimit, shpejtësinë dhe fleksibilitetin në trajtimin e problemeve, si dhe mungesën e shpenzimeve, pasi veprimtaria e tij është pa pagesë.

Në vijim të analizës sonë, theksojmë se, në kuadër të bashkëpunimit gjatë procesit të zhvillimit të hetimit administrativ, evidentojmë faktin se gjatë komunikimit institucional me Bashkinë Shijak kemi konstatuar se në disa raste nuk janë kthyer përgjigje shkresave të dërguara nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Ndërsa në disa raste të tjera ka rezultuar se edhe pse janë kthyer përgjigje në aspektin formal lidhur me kërkesat për shpjegime apo informacion të dërguara nga Avokati i Popullit, në vlerësimin tonë ato nuk mund të konsiderohen të tilla në aspektin substancial. Kështu në përgjigjet e dhëna nga Bashkia Shijak, ka rezultuar se në mënyrë të përsëritur, nuk janë kthyer përgjigje çështjeve të specifikuara për informacion nga

ana e Institucionit të Avokatit të Popullit në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të cilat kanë rëndësi për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

Duke e konsideruar refuzues qëndrimin e mbajtur prej Bashkisë Shijak në më shumë se në një rast, çmohet se ky qëndrim ka cenuar një ndër parimet më të rëndësishme, parimin e bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike.

Parimi i bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike, është sanksionuar si në parimet e Kodit të Proedurës Administrative, ashtu edhe në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore”. Neni 3, i këtij ligji parashikon se: *1. Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, efijencës dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucioneve të pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin”.*

Në këtë kontekst, sqarojmë se, bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Mungesa e informacionit dhe e dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme, apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e qytetarëve tek shteti i së drejtës dhe administrata shtetërore ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel evropian por edhe të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikatori.

Besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm jo vetëm për t’u mbrojtur nga normat dhe parimet kushtetuese, por edhe nga veprimtaria e administratës gjatë veprimtarisë së saj, e cila duhet të garantojë ligjshmërinë e veprimeve që shteti kryen me qytetarët e tij, sigurinë juridike se qytetari është objekt i veprimeve të ligjshme dhe se institucionet shtetërore do i garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të tij.

Në konkluzion të sa u parashtrua dhe arsyetua në këtë rekomandim, vlerësojmë se sjellja e Bashkisë Shijak përkundrejt ankuesit por edhe përkundrejt adresimit të situatës në tërësi nuk garanton standardin e nevojshëm për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve.

Për më tepër, është detyrë e organeve administrative që, në përputhje me parimin e përgjegjësisë dhe atë të bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërinstitucional, të mos i mbyllin rrugën administrative një qytetari të dëmtuar nga gabime të dokumentuara të vetë administratës. Aq më tepër kur ekziston qartazi mundësia dhe detyrimi ligjor për zgjidhje në rrugë administrative, përbën jo vetëm shmangie nga përgjegjësia institucionale, por edhe një formë e heshtur e mohimit të së drejtës për trajtim të barabartë dhe efikas nga organet publike. Institucioni i Avokatit të Popullit e konsideron këtë qasje të papranueshme dhe në kundërshtim me standardet e së drejtës administrative bashkëkohore, e cila vendos në qendër mbrojtjen efektive të individit dhe korrigjimin me përparësi të padrejtësive të shkaktuara nga vetë shteti.

Gjatë trajtimit të kësaj çështjeje është me vend të sjellim në vëmendjen tuaj, parimin e përgjegjësisë në veprimtarinë e organeve publike të parashikuar në nenin 15, të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet shprehimisht se: *“Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi”*.

Referuar ligjit nr. 8510 datë 15.07.1999, *“Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”*, të ndryshuar, (ligji nr.8510/1999), realisht ankuesit i është shkaktuar një dëm pasuror, në kushtet e trajtimit jo në përputhje me parashikimet ligjore të kësaj çështjeje. Në kuptim të përgjegjësisë jashtëkontraktore, si një detyrim i organeve të administratës shtetërore, për të shpërblyer dëmin që i është shkaktuar interesave të ankuesit si person privat, në ushtrim e sipër të funksioneve tuaja publike, rasti në fjalë parashikohet në nenin 3, paragrafi “a”, të ligjit nr.8510/1999, ku parashikohet se: *“Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë private, në rastet që vijojnë, ... -Kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme”*. Kujtojmë se, organet e administratës shtetërore janë të detyruara që qytetarëve t’u sigurojnë, realizim të drejtë dhe efikas të të drejtave, lirive kushtetuese e ligjore, si dhe interesave të tyre të ligjshme gjatë një procedure administrative. Të drejta dhe interesa këto të vërtetuara dhe të njohura me ligj. Në ushtrimin e veprimtarisë tuaj duhet të udhëhiqeni nga parimi i ligjshmërisë dhe përgjegjshmërisë në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara. Kjo pasi çdo organ administrativ duhet ta mbështesë veprimtarinë e tij administrative tek parashikimet ligjore e nënligjore, si dhe të përgjigjet për veprimet e tij tek autoritete të tjerë administrativë, legjislativë ose juridikë. Përgjegjshmëri do të thotë gjithashtu që asnjë autoritet nuk duhet të përjashtohet nga hetimi, duke përfshirë hetim nga gjykatat, ankim tek një organ administrativ më i lartë, investigim nga Avokati i Popullit, inspektim nga një bord ose komision special dhe hetim nga një komision parlamentar. Përgjegjshmëria është një instrument që tregon nëse respektohen parimet e ligjshmërisë, të qenit i hapur, parimi i transparencës, parimi i paanësisë dhe barazisë para ligjit. Përgjegjshmëria është esenciale për të siguruar vlera si efica, efektiviteti, besueshmëria dhe parashikueshmëria e administratës publike.

Mbi këtë bazë dhe në përputhje me parashikimet e bëra në nenet 5 dhe 8, të ligjit nr.8510/1999, ju si organ publik, duhet tashmë që të filloni një procedurë administrative për njohjen e dëmit që i keni shkaktuar z. E. K. duke marrë për bazë edhe dispozitat respektive të Kodit Civil, për shkaktimin e dëmit, si dhe nxjerrjen e përgjegjësisë përkatëse.

Ankesat e z. E. K. nuk janë shqyrtuar në mënyrë efektive dhe nga mosveprimi i tyre i paligjshëm mund të rezultojë përgjegjësi për çdo pasojë të ardhur në rast shembje të banesës. Po ashtu rezulton se duhet të përfitojë masën e bonusit të qirasë së banesës deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje.

Në përfundim, referuar shkresës së Institutit të Ndërtimit, vlerësojmë se është e qartë se pasaktësia ka ardhur si pasojë e një gabimi material nga ana e Bashkisë Shijak sa kohë që Instituti Ndërtimit shprehet se **në databazën e Institutit të Ndërtimit nuk ka akt ekspertize me shkallë dëmtimi DS2, por është vetëm akt ekspertiza “DS4”, për rastin në fjalë.** Në këto kushte, konstatohet se vendimi është marrë në mungesë të fakteve të sakta dhe në kundërshtim me aktekspertizën e thelluar, duke cënuar në këto kushte të drejtën e qytetarit për përfitim të barabartë nga programi i rindërtimit sipas legjislacionit në fuqi, si edhe duke cënuar të drejtën e tij për një strehim të përshtatshëm. Për pasojë ky konstatim i dalë si pasojë e hetimit administrativ, ka vlerë shfuqizuese për çdo vendim të marrë në bazë të një pasaktësie faktike, dhe duhet të çojë në rishqyrtimin e menjëhershëm të rastit, duke marrë në konsideratë të drejtën legjitime të ankuesit për të përfituar nga programi i rindërtimit konform ligjit.

Sa më lart, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 63 paragrafi 3, në të cilin parashikohet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, neni 21/b në të cilin thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave nga Bashkia Shijak për rishikimin e praktikës së z. E. K. (P. K.) për të garantuar respektimin e plotë të së drejtës së qytetarit për përfitimin nga fondet e rindërtimit për banesën e dëmtuar për shkak të fatkeqësisë natyrore dhe rishqyrtimin e këtij rasti nga ana e Bashkisë Shijak.
2. Marrjen e masave nga Bashkia Shijak për bashkëpunim me Institutin e Ndërtimit për rastin e z. E. K. (P. K.) si dhe mospërsëritjen e rasteve të tjera të ngjashme, për të evituar gabimet e mundshme në të ardhmen.
3. Shpërblimin e dëmit të shkaktuar ankuesit, sipas parashikimeve të vlerës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
4. Marrjen e masave të nevojshme nga Bashkia Shijak që gjatë ushtrimit të veprimtarisë në drejtim të ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët të jetë më fleksibël, duke dëgjuar/adresuar drejtë qytetarët si dhe duke respektuar maksimalisht të drejtat e tyre.
5. Marrjen e masave përkatëse për të adresuar mungesën e komunikimit korrekt me institucionin e Avokatit të Popullit sa i përket kërkesave për informacion, përgjigjet e

të cilave kanë rezultuar me përmbajtje të paplota në disa aspekte, me qëllim që kjo situatë të mos përsëritet në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi si dhe masat disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh, konform nenit 22, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “ Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- korrespondencën përkatëse të Institutit të ndërtimit me Bashkinë Shijak; shkresën nr. 507/1 prot ., kopjen e akt ekspertizës datë 21.02.2020, shkresën nr. 645 prot., për dërgimin e aktekspertizës së thelluar datë 02.03.2020.(gjithsej 5 faqe) .

KOMISIONERE

ERINDA MELI

d.v